



**Informacione
të rëndësishme
për pranimin
në urgjencë**

Spital Bülach



Orari i hapjes së repartit të urgjencës

Reparti i urgjencës është hapur për të gjithë pacientët gjatë gjithë kohës, 365 ditë në vit.

Orari i hapjes së klinikës së urgjencës

Nga e hëna në të premte Ora 08:00 - 21:00

Të shtunën dhe të dielën Ora 09:00 - 21:00

Orari i hapjes së Airport Medical Center

Aeroporti i Zyrihut

hapur çdo ditë

Ora 07:30 deri 19:00

Kur klinika e urgjencës nuk është hapur, të gjithë pacientët e urgjencës do të trajtohen në repartin e urgjencës të spitalit Bülach.

Spital Bülach AG

Spitalstrasse 24

CH-8180 Bülach

www.spitalbuelach.ch

Spital Bülach



**NË RASTE
EMERGJENTE**

I dashur pacient, e dashur paciente

Ju do të ekzaminoheni së shpejti nga një ekspert i urgjencës. Pas dhënies së ndihmës së parë do të caktoheni tek **klinika e urgjencës** ose tek **reparti i urgjencës**.

Ekipi i urgjencës ju uron shërim të shpejtë.



1 person shoqërues për çdo pacient

Për shkak të kompleksitetit, personi juaj shoqërues juaj nuk mund të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit. Sapo ai të jetë kryer, shoqëruesi juaj mund t'ju bashkohet




Ju rekomandojmë të përdorni **Wi-Fi tonë falas**. Ju lutemi, pyesni për procedurën e hyrjes në Wi-Fi tek recepsioni.



Mendimi juaj është i rëndësishëm për ne

Në ditët në vijim do të merrni një SMS ku mund të vlerësoni cilësinë e trajtimit.



Kohët e pritjes

Pas vlerësimit fillestar, kohët e pritjes deri në marrjen e trajtimit ndryshojnë sipas vendit të trajtimit.

Klinika e urgjencës

Pacientët trajtohen sipas radhës.

Reparti i urgjencës

Trajtimi bëhet sipas vështirësisë së rastit.

Ndërkohë që prisni radhën, mund edhe të largoheni nga dhoma e pritjes. Në këtë rast informoni recepsionin. Aty do të merrni një pajisje që do t'ju njoftojë sapo të vijë radha juaj për trajtim.

Pacientët merren nga dhoma e pritjes.

Ekipi ynë përpiqet t'ju trajtojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Për shkak të numrit të madh të pacientëve, kohët e pritjes mund të jenë më të gjata.

Shumë faleminderit për mirëkuptimin tuaj